

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist	Reparti Ushtarak Nr. 6640 K.K.N.	Tiranë	Pa afat	Po	Po	12.08.2025	26.08.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Specialist.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Sektori Operacional i Mbrojtjes Kibernetike, në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike MM/SHPFA, Qendra Operacionale Kibernetike/Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, në Reparti Ushtarak Nr.6640, Komanda Kibernetike dhe Ndërlidhjes.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 12.08.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 26.08.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [\(linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit\)](http://www.mod.gov.al)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|--------------------------|---|
| a. Grada/Titulli: | Specialist. |
| b. Arsimi: | Të ketë përfunduar ciklin e I-rë të studimeve “Bachelor” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në AFA, në degën Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes dhe/ose të barasvlershëm me të në universitetet publike dhe private brenda dhe jashtë vendit |
| c. Kualifikimi: | Të zotërojnë diplomë niveli i II-të master profesional/shkencor për Sigurinë Kibernetike, ose të tjera të barasvlershme me të. |

d. Trajnimi: Preferohen kurse në fushën e sigurisë kibernetike. e. Eksperienca në Punë: Jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën profesionale f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze. Kërkesa të tjera specifike: Njohuri mbi Sistemin Operativ Linux, Windows. g. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.	
Përshkrimi i punës: Detyra kryesore e specialistit për Sistemet e Sigurisë Kibernetike është përgjegjës për monitorimin në kohë reale të alarmeve të sigurisë, kryerjen e analizave fillestare dhe përshkallëzimin e ngjarjeve që përmbajnë rrezik të mundshëm për SKI të MM/FA. Detyrat kryesore: • Monitoron aktivitetin ditor të rrjeteve kompjuterike dhe të sistemeve të komunikimit dhe informacionit të FA. • Detekton në mënyrë pro-aktive kërcënimet kibernetike dhe parandalon, zbut sulmet/kërcënimet kibernetike përpara se ato të arrijnë komprometimin e SKI-ve të MM/FA. • Analizon, zbulon dhe lufton në mënyrë të pandërprerë të gjitha llojet e kërcënimeve kibernetike. • Mbledh vazhdimisht të dhëna mbi sjelljen, qëllimin dhe metodat e kërcënimeve kibernetike. • Organizon dhe analizon të dhënat e mbledhura me qëllim përcaktimin e trendit të mjedisit të sigurisë së MM/FA. • Raporton në kohë reale mbi kërcënimet e mundshme të detektuara dhe bashkëpunon ngushtë me sektorin e analizës me qëllim zbutjen dhe neutralizimin e kërcënimit aktual. • Ndjek hap pas hapi procedurat e përcaktuara për secilin lloj incidenti. • Në rast detektimi të kërcënimeve, zbaton dhe merr masa konkrete për të zbutur dhe bllokuar sulmin e mundshëm. • Regjistron çdo alarm të trajtuar në sistemin e menaxhimit të incidenteve (SIEM/SOAR), duke përfshirë informacion teknik dhe rekomandime të mundshme. • Ndjek hap pas hapi procedurat e playbooks të përcaktuara për secilin lloj incidenti (phishing, malware, brute force, etj)	
13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: ▪ përzgjedhjen paraprake; ▪ vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; ▪ intervistën e strukturuar me gojë. • Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe	

përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës së strukturuar), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur vakant.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.